



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Forcës së Sigurisë
Ministarstvo Snaga Bezbednosti Ministry of Security Force

Departamenti i Personelit/ Odsek za personal/Department for Personnel

Në mbështetje të nenit 145, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr.2003/01, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës shpall këtë:

RISHPALL KONKURS

Titulli i punës: **Zyrtar i QKD-së; MFSK 2244**

Mbikëqyrësi: Shefi i Qendres Koordinuese për Deminim
Kohëzgjatja e kontratës: 36 muaj
Niveli i pagës: A 2
Orari: I plotë
Vendi i punës: Prishtinë

Përshkrimi i punës: Ministria e Forcave të Sigurisë së Kosovës (MFSK) ushtron mbikëqyrje civile dhe kontroll demokratik mbi FSK-në dhe udhëhiqet nga Ministri i FSK-së, i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Ministria është përgjegjëse për zbatimin e politikave qeveritare për sa iu përket çështjeve që ndërlidhen me FSK-në dhe poashtu do të veprojë edhe si shtabi i nivelit më të lartë të FSK-së. Detyrat e Ministrisë përfshijnë menaxhimin e personelit; menaxhimin e buxhetit dhe aktiviteteve të prokurimit; çështjet e zbulimit dhe sigurisë së FSK-së; përgatitjen e dokumenteve politike dhe ligjeve dhe rregulloreve të FSK-së; marrëdhëniet e FSK-së me popullatën civile; trajnimin, pajisjet dhe infrastrukturën e FSK-së; mbështetjen logjistike dhe mjekësore; bashkëpunimin ndërkombëtar; dhe këshillimin rreth shfrytëzimit të FSK-së për veprime (operacione) në Kosovë apo jashtë vendit. Përveç shërbyesve civil, të cilët do të përbëjnë shumicën e stafit, Ministria do të ketë edhe pjesëtarë të FSK-së të cilët do të përfshihen në detyra të posaçme me rotacion.

Qendra Koordinuese për Deminim (QKD) është njëri nga katër sektorët e Departamentit të Operativës dhe Trajnimit brenda Ministrisë. Sektori ka mandat të veprj si Autoritet Kombëtarë për Deminim dhe Qendra Koordinuese për Deminim në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara. Përveç kësaj, kjo zyre dhe personeli i saj veprojnë si ndërlidhës me KFOR-in / NATO si dhe me organizatat tjera ndërkombëtare dhe vendore, dhe si qendër operative për reagim në rastet emergjente për deminim (EOD) në Kosovë. Nga qendra mund të kërkohet që ata të operojnë 24 orë në ditë, dhe duhet të kenë personel anglisht folës.

Qëllimi i postit:

- Zyrtari do të ketë përgjegjësi kryerjen e detyrave të dhëna sipas mandatit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvillimi i trajnimeve për Edukim mbi Rrezikun nga Minat (ERM) me FSK-në, KFOR-in dhe OJQ-të.
- Zhvillimi i Edukimit mbi Rrezikun nga Minat (ERM) - kapacitet ndërlidhës për ekipin e EOD-së e FSK-së dhe OJQ-ve të përfshira në pastrimin e minave..
- akrediton dhe monitoron zbatimin e aktiviteteve të edukimit mbi rrezikun nga minat me FSK-në, OJQ-të, KFOR-in dhe institucionet vendore.
- Këshillon dhe ndihmon FSK-në, OJQ-të, KFOR-in dhe institucionet vendore në zbatimin e Edukimit mbi Rrezikun nga Minat në qoftë se dhe kur kërkohet.
- Krijimin e SOP-së për zbatimin e Edukimit mbi Rrezikut nga Minat të bëjnë me FSK-në, OJQ-të, KFOR-in dhe institucionet vendore.

- Analizon dhe përgatit informacion për raportet e marra për vende të rrezikshme dhe të dyshuar.
- Ofron udhëzime dhe trajnim për edukimin mbi rrezikun nga minat për OJQ-të dhe institucionet lokale për të përcjellur atë në shoqërinë.
- Ofron Edukimin mbi Rrezikun nga Minat direkt në komunitet, nëse dhe kur kërkohet.
- Ofron për Partnerët zbatues informacionet e fundit dhe të azhurnuara për vende të rrezikshme.
- bashkëpunon ngushtë me aktivitetet e informimit publik.
- shqyrton dhe diskuton gjitha materialet e përgatitura nga partnerët zbatues për publikim në media dhe në përputhje me udhëzimet e SIMD-së.
- Operon me VHF radio sistemin emergjentë me njësinë EOD të FSK-së, OJQ-ve dhe KFOR-in.

Shkathësitë, përvoja dhe karakteristikat tjera:

- Duhet të jetë profesional, me përvojë dhe i besueshëm si dhe i aftë që t'i kryej në mënyrë profesionale detyrat e dhëna sipas mandatit dhe ato shtesë brenda periudhës së pranueshme kohore.
- Duhet t'i ketë shkathësitë e mira organizative.
- Duhet të përdor maturinë gjatë punës me njerëz dhe detyrën.
- Duhet të jetë i motivuar lartë dhe të ketë etik të fort pune.
- Ai/ajo duhet të jetë në mundësi që të punoj i/e mëvetësishme si dhe të punoj si ekip me punonjës të tjerë në përmbushjen e detyrave të dhëna

Kualifikimet e nevojshme:

- Përvojë profesionale në Qendrat Koordinuese për Deminim ose organizatave humanitare për deminim, me përvojë prej 4-6 vite në sigurimin e cilësisë.
- Trajnim dhe certifikim në Operacionet e Deminimit Humanitarë, përparësi kanë ato sipas standardeve të IMAS të OKB-së. Trajnimi dhe certifikimi duhet të përfshijë sigurimin e cilësisë dhe nivelet për trajnim në deminim për të siguruar kuptim gjithëpërfshirës të operacioneve të deminimit. Trajnim dhe certificate për vetëdijësimin e rrezikut nga minat
- Njohuri të mira në gjuhën shqipe apo serbe, dhe angleze

Kualifikimet e dëshiruara:

- Shkollimi universitar është i dëshirueshëm
- Përvojë profesionale me organizata humanitare, organizata ndërkombëtare, ose OJQ është përparësi. Preferohet të ketë kapacitet të demonstruar në kryerjen e programit për sigurim të cilësisë.

Si të aplikoni: Formularët për aplikim janë në dispozicion në Departamentin e Personelit të M-FSK-së, apo në web-faqen e M-FSK-së, www.mksf-ks.org, apo www.ks-gov.net/mfsk ku gjendet shpallja e konkursit. Formularët duhet t'i dorëzohen Departamentit të Personelit personalisht, apo të dërgohen me postë në këtë adresë: **Ministria e FSK-së, Lagja Emshiri 1, 10000 Prishtinë, Departamenti Personelit, Kati II, (Ish-ndërtesa e Shtabit të Përgjithshëm të TMK-së)**, Prishtinë, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Kandidatët duhet t'ia bashkëngjisin aplikacionit kopjet e dokumenteve që dëshmojnë përmbushjen e kushteve të nevojshme. **Numrat kontaktues:** Për informata plotësuese, mund të thirrni në numrin telefonik kontaktues nr.: 038 200 13 508. Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes së parë në të përditshmet kosovare. Data e fundit e aplikimit është 10.12.2010. Edhe aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, do të konsiderohen valide. Kandidatët duhet t'ia bashkëngjisin aplikacionit kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe kopjet e dokumenteve që dëshmojnë për kualifikimet e tij/saj. Kjo pozitë i nënshtrohet procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të procesit të verifikimit. Për shkak të numrit të madh aplikacioneve, vetëm kandidatët e përzgjedhur dhe të shënuar në listën e shkurtë do të njoftohen. Kandidatët e ftuar në intervistë duhet t'i sjellin kopjet origjinale të dokumenteve të dorëzuara për rishikim. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës iu shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikacione të femrave dhe meshkujve, pa dallim nga përkatësia e tyre etnike.